

VAKËFI



Autor:

Dr. Musli VËRBANI

Titulli:

VAKËFI

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Shkumbim Jakupi

Botues: **Autori**

Shtypi:

“FokusPrint”, 2013

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Dr. Musli Vërbani

VAKËFI

Kaçanik, 2013

HYRJE

Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim

Falënderojmë Allahun, i cili e ka bërë Kur'anin udhëzim për njeriun, shërim të zemrave, mëshirë për nevojtarët, kënaqësi të shpirtave.

Përsëndetjet qofshin për të dashurin tonë, imamin e të dërguarve, i cili ka kryer emanetin, ua ka sqaruar njerëzve se çka u është shpallur dhe ua ka lënë kandilin, i cili në errësirën më të madhe të natës ndriçon si të ishte ditë.

Qoftë i kënaqur Allahu me shokët e tij të singertë, të cilët kanë dëgjuar fjalët e tij, të cilët kanë pasuar veprat e tij dhe kanë praktikuar këshillat e tij.

Qoftë i kënaqur Allahu edhe me tabiinët (gjeneratën e dytë), të cilët kanë vazhduar realizimin e planprogramit të tyre dhe janë udhëzuar prej udhëzimeve të tyre, si dhe për të gjithë ata të cilët pasojnë rrugën e tyre deri në ditën e gjykimit.

Lexues të nderuar, jeta është dhuratë prej Allahut. Edhe pasuria është dhuratë prej Allahut. Allahu të dhuron (të falë) diçka, e pastaj e Zoti i Lartëmadhëruar atë që e ka dhuruar falas e kërkon që ti jepet me kompenzim. Për dhurimin e jetës për Allah, Zoti ta kompenzon me xhenet; për dhurimin e pasurisë për Allah, Zoti ta kompenzon me xhenet dhe njëherit fiton kënaqësinë e Tij.

Zoti i lartmadhëruar në Kur'anin fisnik ka thënë:

“Allahu ka blerë nga besimtarët jetët dhe pasuritë e tyre në shkëmbim të xhenetit”.(et-Tevbe, 111)

Po ashtu, ka thënë:

Ka të tillë ndër njerëz që sakrifikojnë veten dhe pasurinë e tyre për të fituar kënaqësinë e Allahut .(el-Bekare,207)

Zoti i lartmadhëruar është i Gjithpushtetshëm. Çdo gjë që është në qiej dhe në tokë Ai e ka krijuar me vullnetin e Tij dhe është e Tij. Ai është i pavarur nga gjithçka dhe çdo gjë është e varur prej tij.

Zoti i lartmadhëruar, pasi që njeriut ia ka dhënë jetën, Ai nuk ka nevojë për jetën e tij, por njeriu (njërëzit) ka(në) nevojë për lartësimin e fjalës së Allahut, sepse me lartësimin e fjalës së Allahut në tokë mbizotëron qetësia dhe harmonia; poashtu me dhurimin e pasurisë, me fjalë të tjera, lënien vakëf, pra lënien e pasurisë në pronësi të Allahut, nuk do të thotë se Allahu ka nevojë për atë pasuri, por njerëzit dhe krijesat kanë nevojë ta shfrytëzojnë dhe të përfitojnë prej asaj pasurie, e cila titullohet se është në pronësi të Allahut, pasi që ajo pasuri sjell zhvillim ekonomik dhe lumturi për njerëzit dhe krijesat në përgjithësi. Njeriu nuk është i mirë kur i bën mirë vetëm vetes, por kur të tjerëve u bën mirë. Maksima e thënë prej Muhamedit s.a.v.s është:

“Më i miri i njerëzve është ai i cili u bën mirë njerëzve”.

Nëse mëshirohen dhe u bëhët mirë krijesavë në tokë, Krijuesi nga qielli mëshiron bamirësinë. Përhapja e bamirësisë në tokë sjell kënaqësi shpirtërore, paqe, lumturi dhe harmoni, ndërsa e kundërta, nëse përhapet shpirtligësia, atëherë paraqitet dis-harmonia, urrejtja dhe kriza ekonomike e psiko-morale.

Lusim Zotin e lartmadhëruar që të na bëjë prej atyre, të cilët falënderojnë për begatitë e Tij, shërbehem me dhuntitë e Tij, dhurojmë dhe lëmë vakëfe në ëmër të Tij; fitojmë kënaqësitë e Tij dhe të shpërblehem me xhenetet e Tij.

VAKËFI

Vakëf gjuhësisht do të thotë: mbyllje, ndalim. Thuhet: *“E mbylla shtëpinë për xhami”*, që nënkupton se ajo shtëpi destinohet për t’u shpenzuar vetëm për nevojat e asaj xhamie.

Vakëf në terminologji do të thotë: Të mbyllurit e shtëpisë apo të ndonjë pasurie të paluajtshme në rrugë të Allahut, e kjo do të thotë që përfitimi prej asaj pasurie të paluajtshme të shpenzohet për studentët, jetimët, për luftëtarët në rrugën e Allahut, për të varfrit, për çështje humanitare, etj.

Vakëfi ka karakter fetar, i cili ndihmon dhe zhvillon fenë. Mirëpo, pasi që feja Islame është fe universale, është fe e cila ka zbritur për të siguruar paqe, lumturi dhe prosperitet në këtë botë dhe fitimin e xhenetit në botën tjetër, edhe në të kaluarën, por edhe në ditët e sotme vakëfet janë institucion edhe për nevojat e njerëzimit në përgjithësi, siç janë ndërtimi i urave, rrugëve, banjave publike, hoteleve pa pagesë etj. Po ashtu, vakëfet shërbejnë edhe për ruajtjen e ambientit, për sigurimin edhe të kafshëve, bile edhe të shpendëve.

ARGUMENTI I LIGJËSIMIT TË VAKËFIT

Transmetohet nga Ibn Omeri r.a. se Omeri r.a. e ka fituar një parcelë toke të Hajberit e pastaj shkon te Muhamedi s.a.v.s. të cilit i thotë: O i dërguar i Allahut: Kam fituar një parcelë toke në Hajber dhe në jetën time pasuri më të çmueshme për veten asnjëherë nuk kam pasur. Ç'më kishe këshilluar për këtë parcelë?

Muhamedi a.s. i thotë: Nëse dëshiron, mbylle (lëre vakëf) dhe jep sadaka.

Omeri r.a. e la vakëf (e dha sadaka) dhe ka porositur që ajo tokë: **të mos shitet, të mos dhurohet, të mos trashëgohet (pronësohet), por të mirat e asaj toke të jenë për të varfrit, të afërmit, për të liruar robërit, për udhëtarët, për mysafirët.**

Transmeton xhemati (grup transmetuesish)

Pejgamberi s.a.v.s. i ka dhuruar shtatë kopshte hurmash, të cilat i kishte në Medinë.

Pas Muhamedit s.a.v.s. edhe shokët e tij kanë ndjekur rrugën e tij duke dhuruar vakëfe që sillnin të ardhura të mira. Ja disa shëmbuj të mirësisë së shabeve:

- Enesi r.a. ka thënë: “Kur i dërguari i Allahut erdhi në Medinë, urdhëroi të ndërtohej xhamia dhe tha: O fisi Beni Nexhar, a ma lini mua në disponim truallin tuaj?!

Ata i thanë: Për Allahun ne nuk kërkojmë çmim për të, përveç se shpërblim nga Allahu i Lartmadhëruar,

Atëherë pejgamberi s.a.v.s e mori dhe ndërtoi xhaminë në atë parcelë.

-Na është përcjellur se Sead Ibn Ubade r.a. i ka thënë të dërguarit të Allahut s.a.v.s.: O i dërguar i Allahut, nëna më ka vdekur. Cila është sadakaja më e mirë për të?

Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: Uji.

Atëherë Seadi e ka hapur një pus dhe ka thënë: Ky pus është (vakëf) për nënën e Seadit.

- Uthmani r.a. tregon se njëherë i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Kush e hap pusin Ruma, ai fiton xhenetin, ndërkaq unë isha i pari që e hapa atë pus në atë vend.

- Një sehabë i quajtur Ebu Talha kur dëgjoi ajetin Kur'anor: "Kurrë nuk mund të arrini mirësinë përderisa nuk e jepni atë që e doni më së shumti", i thotë Muhamedit a.s.: O i dërguar, prona ime më e dashura është plantacioni me hurma i quajtur "Bejruha". Që nga ky moment po ia lë Allahut dhe të dërguarit të Tij. Shpresoj se Allahu ma llogarit si mirësi dhe më furnizon në botën tjetër.

Pas këtij momenti tregohet se Ebu Talha shkoi te plantacioni i hurmave dhe aty e pa të shoqen e tij, e cila rrinte nën hijen e një hurme. Ai nuk hyri brenda. E shoqja e pyeti: Ç'pret aty jashtë, o Ebu Talha? Hyr brenda.

- Unë nuk mund të hyj brenda. Edhe ti mblidhi plaçkat dhe dil jashtë! – i tha Ebu Talha.

- Po, pse, o Ebu Talha? A nuk është yni ky plantacion? – pyeti e habitur e shoqja.

- Jo! Tani ky plantacion është i të varfërve të Medinës – u përgjigj Ebu Talha.

- Mirë, po a e fale vetëm në ëmrin tënd apo të ne të dyve? – e pyeti e shoqja.

- Në emër të të dyve – i përgjigjet Ebu Talha.

Atëherë e shoqja i tha Ebu Talhas: Allahu qoftë i kënaqur me ty, Ebu Talha! Edhë unë kur shihja të varfrit, po këtë mendoja, por nuk kisha guxim të ta thosha! Allahu na e pranofte mirësinë tonë! Ja tek po dal menjëherë.

Xhabiri r.a. ka thënë: Nuk di asnjë nga muhaxhirët (banorët e Mekës) ose nga ensarët (banorët e Medinës) që të kënë pasur mundësi dhe të mos kenë dhuruar (lënë vakëf).

Nuk dimë në ka pasur ndonjë mospajtim të dijetarëve rreth ligjshmërisë së vakëfit.

DISPOZITA E VAKËFIT

Dispozita e vakëfit është **“afrim tek Allahu”**, fitim i kënaqësisë së Allahut dhe shpëtim në botën tjetër.

Vakëfi është ndër veprat nga të cilat njeriu edhe pas vdekjes fiton shpërblime (sevape), derisa prej atij vakëfi përfitojnë njerëzit, kafshët apo shpendët.

Muslimi në sahihun e tij transmeton hadithin e Muhamedit a.s., në të cilin hadith thuhet: **“Kur të vdesë njeriu, veprat e tij (direkt) ndërpriten, përpos tri lloje të veprave (ku do të këtë shpërblim edhe pas vdekjes), e ato janë:**

- Lëmosha qarkulluese,**
- ose dituri prej së cilës përfitohet,**
- ose në lënien e një fëmije, i cili lutet për të edhe pas vdekjes së tij”.**

Sadakaja e rrjedhshme është pikërisht ajo pasuri që lihet si vakëf.

Vakëfi i parë dhe më i rëndësishmi është Mesxhidi Harami, pra Qabeja, së cilës themelet ia ka ngritur dhe e ka ndërtuar Ibrahim i a.s me të birin e tij Ismailin a.s. Tregon Zoti i Lartëmadhëruar:

“Dhe kur Ibrahim i me (të birin) Ismailin i ngritën themelet e Qabes dhe thanë: Zoti ynë, pranoje nga ne. Vërtet Ti je i Ditur dhe Dëgjues”.

QËLLIMI I VAKËFIT

Qëllimi i vakëfit është që të ndihmojë zhvillimin e jetës fetare, pastaj prosperitetin shoqëror, njëherit të ndihmojë edhe shoqërinë në aspekt humanitar.

Feja zhvillohet duke lënë vakëf:

xhami,
mesxhide,
shkolla (medrese),
biblioteka etj.

Shoqëria zhvillohet duke lënë vakëf:

ambulanta,
spitale,
bujtina (pa pagesë),
ura,
rrugë e të ngjashme etj.

Në çështje humanitare u ndihmohet:

jetimëve,
të varfërve,
studentëve,
udhëtarëve,
të sëmurëve,
të ngarkuarve në borxhe,

Përpos në zhvillimin e fesë, prosperitetin e shoqërisë, ndihmave humanitare, vakëfi është institucion, i cili ruan ambientin dhe njëherit është institucion ekologjik, sepse lihet vakëf edhe për ushqimin e kafshëve, bile edhe të shpendëve.

LLOJET E VAKËFIT

Vakëfi është dy llojesh:

1. Vakëfi për fëmijë dhe familjarë dhe

2. vakëfi për të tjerët.

1. Vakëfi për fëmijë dhe familjarë: Vakëfi familjar do të thotë kur bamirësi lë vakëf diçka, por përcakton që një pjesë e atij vakëfi të jetë për familjen e tij, ndërsa një pjesë tjetër për shoqërinë. Mirëpo, pas vdekjes së trashëgimtarëve dhe anëtarëve të familjes së tij, të gjitha të ardhurat e atij vakëfi të jenë për shoqërinë; vetëm se duhet cekur se fëmijët e tij nuk mund të jenë pronarë të asaj pasurie; pronar i vetëm është vetëm vakëfi dhe askush tjetër. Ky lloj vakëfi ka përparësi, nga shkak se nëpërmjet tij bëhet ndërlidhja farefisnore.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Kini frikë Allahun, të cilit i luteni, dhe forconi lidhjet farefisnore.”**(En-Nisa, 1)

Po ashtu, ka thënë: **”Prandaj jepja të afërmit të drejtën e vet, të varfërit dhe udhëtarit.”**(Err-Rrum, 38)

Po ashtu, ka thënë: **”Adhurone Allahun dhe në adhurim mos i bëni idhujtari në asnjë mënyrë. Jini të mirë me prindërit, me të afërmit, me jetimët, me të varfërit dhe me të ngratët, me fqinj të afërt dhe me fqinj të largët...”**(En-Nisa, 36)

2. Vakëfi për të tjerët: Është vakëfi, i cili nuk lihet për fëmijë dhe familjarë, por për interes të përgjithshëm, si për çështje fetare, ashtu edhe për çështje humanitare e sociale.

KUSHTET E VAKËFIT

Kushtet e vakëfit janë më sa vijon:

- **Që vakëflënësi të ketë imunitet**, që do të thotë se nuk pranohet vakëfi i të çmendurit, i fëmijës para pjekurisë, e po ashtu, nuk pranohet vakëfi i të imponuarit.

- **Që të deklarohet**, kjo nënkupton që vakëflënësi të thotë: E kam lënë vakëf këtë apo atë për këtë, pra për të varfërit, jetimët e të ngjashme.

- **Që sendi i lënë vakëf të jetë ligjërisht i lejuar** sipas sheriatit islam. Nuk lejohet që të lihet vakëf si p.sh.: kazino, fabrikë alkooli e të ngjashme.

- **Që sendi i lënë vakëf të ketë jetëgjatësi**, e jo të shpenzohet automatikisht, si p.sh.: nuk lejohet të lihet vakëf ushqimi, domatja, sepse këto gjëra lejohen të jepen sadaka, por nuk janë sende vakëfi.

- **Që sendi i lënë vakëf të jetë i përcaktuar për çështje të caktuara** si p.sh.: të deklarohet se këtë pasuri të paluajtshme e lë vakëf për studentët, për të sëmuret ose për jetimët.

- Vakëflënësi i shëndoshë ka të drejtë të lërë vakëf më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, ndërsa vakëflënësi në shtratin e vdekjes nuk ka të drejtë të lërë vakëf më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, sepse dy të tretat e pasurisë së tij i takojnë trashëgimtarëve. Mirëpo, nëse trashëgimtarët e lejojnë, ai mund të lërë vakëf edhe më shumë se një të tretën e pasurisë.

Nëse trashëgimtarët e lejojnë prindin që të lërë më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, ata nuk kanë drejtë ta rimarrin apo ta rikthejnë pasi që të lihet vakëf.

LËNDA E VAKËFIT

Vakëf mund të lihet çdo lloj pasurie, qoftë e tundshme, qoftë e patundshme.

Në pasuri të tundshme bëjnë pjesë:

- **librat**
- **kafshët**
- **mjetet etj.**

Në pasuri të patundshme bëjnë pjesë:

- **shtëpitë**
- **livadhet**
- **plantacionet**
- **dyqanet etj.**

Vakëfi është i vlefshëm nëse pasuria është e fituar në mënyrë të lejuar (hallall). Për këtë arsye, nuk lejohet që vakëfi të lihet prej pasurisë së fituar në mënyrë të palejueshme (haram), si p.sh.: të lihet vakëf nga pasuria e fituar prej kumarit, bastoreve, lotarive e të ngjashme.

Nuk lihen vakëf çështjet të cilat konsumohen apo shpenzohen, si psh: perimet, veshmbathjet, artikujt ushqimor etj.

Ashtu siç lejohet vakëfi horizontalisht, lejohet edhe ai vertikalisht, pra, lejohet që të lihet vakëf kati i dytë apo i tretë i ndërtesës, edhe pse mbi atë banesë apo nën atë banesë ka pronarë të tjerë përpos vakëfit.

VLEFSHMËRIA DHE REGJISTRIMI I VAKËFIT

Vakëfi mund të lihet me shkrim dhe deklarativisht.

Sipas drejtimit Hanefij, vakëfi është i vlefshëm prej momentit të deklarimit para dy dëshmitarëve, por në këtë rast vakëfi është jo obligativ. Obligativ bëhet kur gjyqtari sjell pas këtij momenti vendimin për atë vakëf dhe të regjistrohet.

Në shek. II është bërë rrëgull që vakëfi të regjistrohet.

Regjistrimi i vakëfit bëhet:

- ose nëpërmjet shprehjes së vullnetit para gjyqtarit, dëshmitarit dhe mutevelijes.

- ose nëpërmjet shprehjes së dëshirës së fundit, pra nëpërmjet testamentit.

Sipas nxënësit të tij, Ebu Jusufit, duhet të zhvillohet kjo procedurë, e cila në praktikë veç ka gjetur zbatim:

Vakëflënësi deklaron para gjyqtarit dhe dëshmitarëve se e lë vakëf parcelën e caktuar për çështje të caktuar.

Gjyqtari e regjistron dhe e titullon në vakëfname.

Pastaj, **vakëflënësi** ngre aktpadi formale kundër **mutevelijes** dhe kërkon që vakëfi t'i kthehet.

Mutevelija e kundërshton kthimin e vakëfit të vakëflënësit.

Pastaj, gjyqtari sjell vendim në dobi të vakëfit; i refuzohet vakëfi vakëflënësit dhe vakëfi merr vendim përfundimtar.

Ky proces është paraparë që t'u iket pengesave të mëvonshme nga trashëgimtarët e vakëflënësit.

Vakëfi mund të lihet edhe nëpërmjet testamentit, pa marrë parasysh se ai testament a është testament deklarativ apo me shkrim dhe në prezencë të dëshmitarëve; vetëm se në këtë rast mund të lihet vakëf vetëm një e treta e pasurisë.

TEPRICA E VAKËFIT SHPENZOHEP PËR TË NGJASHME

Kemi treguar se vakëf do të thotë mbyllje dhe ndalim për diçka, pra kur një individ e mbyll dhe e përcakton diçka për një çështje të caktuar. Nga kjo rezulton se:

-Nëse një vakëf lihet për një xhami të caktuar, ai vakëf shfrytëzohet vetëm për atë xhami.

-Nëse xhamia i përmbush nevojat prej atij vakëfi dhe mbetet tepricë, atëherë prej vakëfit të xhamisë, së cilës i ka mbetur tepricë, shpenzohet vetëm për ndonjë xhami tjetër, e jo për spital apo për çështje tjera.

Nëse një vakëf lihet për një spital të caktuar, ai vakëf shfrytëzohet vetëm për atë spital, e jo për çështje të tjera.

Nëse spitali i përmbush nevojat prej atij vakëfi dhe mbetet tepricë, shpenzohet vetëm për ndonjë spital tjetër, e jo për diçka tjetër, sepse qëllimi i vakëfit është i të njëjtit lloj të vakëfit, e jo i të ndonjë lloji tjetër.

Analizo kështu me radhë edhe për vakëfet tjera të llojeve të tjera.

DALLIM NË MES TË VAKËFIT DHE SADAKASË

Edhe vakëfi, edhe sadakaja (lëmosha), që të dyja, janë **“afrim tek Allahu i Lartmadhëruar”**, pra kjo është pikëpërbashkësia e tyre. Mirëpo, në mësyre ka dallime, e ato janë:

- **Sadakaja** lejohet që të pronësohet, të shitet, të dhurohet, të shpenzohet në tërësi, përderisa

-sa i përket vakëfit, **vakëfi** nuk lejohet as të pronësohet, as të shitet, as të harxhohet, as të dhurohet e as të trashëgohet.

- Sadakaja jepet në çdo çështje, e cila shfrytëzohet, pa marrë parasysh a shpenzohet menjëherë, si f.v. ushqimi, veshmbathja e të ngjashme, përderisa

- sa i përket **vakëfit**, nuk lejohet në ushqim dhe gjëra që harxhohen për në çështje të cilat mbeten afatgjatë, sepse ne e kemi sqaruar edhe më parë se **“vakëf”** gjuhësisht do të thotë ndalim dhe mbyllje.

- **Sadakaja** u jepet vetëm të varfërve, ndërsa,

- **vakëfi** lihet edhe për të pasurit, edhe për të varfrit, edhe pse në vakëf prapëseprapë kanë përparësi të varfrit ndaj të pasurve.

NDRYSHIMI DHE TJETËRSIMI I VAKËFIT

Tjetërsimi i vakëfit, në çfarëdo lloj forme qoftë, nuk lejohet. Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë:

“Dhe kush e ndryshon atë pasi ta ketë dëgjuar atë, atëherë pa kurrëfarë dyshimi mëkati për këtë bie mbi ata të cilët e kanë ndryshuar (destinimin e tij). Vërtet Allahu dëgjon dhe është i ditur.”(El-Bekare,181).

Parashtrohet një pyetje tjetër: A lejohet zëvendësimi, kur zëvendësimi i vakëfit është i domosdoshëm.

Përgjigja është: Kur zëvendësimi i vakëfit është i domosdoshëm, që do të thotë kur ta humbë vlerën e tij plotësisht, në këtë rast shitet dhe blihet apo ndërtohet vakëfi i dytë, i cili do ta ketë të njëjtin destinacion si i pari.

Vakëfi i zëvendësuar duhet të jetë si i pari ose më i mirë se ai, ndryshe nuk lejohet.

Nuk lejohet shitja e vakëfit dhe shpenzimi për gjëra ditore të përditshme, si në dhënie të pagave mujore apo në investime që shpenzohen dhe nuk mbeten të përgjithmonshme.¹

1. Vakëfi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Ferizaj prej 6 banesave, të cilat banesa janë shitur dhe:

Një banesë e ka blerë nënkryetari i BIK-ut ef Fahrush Rexhepi; kjo është e ndaluar (Haram).

Një banesë, të cilën e ka blerë Kryetari i Kryetari i Këshillit të BIK të Ferizajt Femi Memeti, dhe ai pastaj e ka shitur te Kreshnik Avdiu menjëherë pas disa javëve apo muajve, për të bërë tregti me vakëfin; edhe kjo është e ndaluar (Haram).

Një banesë e ka blerë ef Sevdairi; edhe kjo është e ndaluar (Haram), sepse këta kanë bërë abuzimin e Vakëfit. Përpos që e kanë shitur vakëfin dhe atë ia kanë shitur vetes, ata nuk kanë blerë vakëf më të ri apo të ngjajshëm me vakëfin e mëhershëm, sepse në këtë kohë të jetë vakëf banesa në qendër të Ferizajt do të thotë se vështirë të gjendet zëvendësim më i mirë.

DESTINIMI I TË HYRAVE TË VAKËFIT

Dijetarët islamë janë të pajtimit se nuk guxon të ndryshojë destinimi i të hyrave të vakëfit dhe nuk lejohet të shpenzohet në çështje tjera, përpos ashtu siç e parasheh, apo kushtëzon vakëflënësi. Rregull është: **SHARTUL VAKFI KE NASI SHARIE**, që do të thotë: **Kushti i vënë në vakëf është njësoj si Ligji i Zotit – Ligjvënës**. Kjo nënkupton se ashtu siç nuk lejohet të ndryshohet një ajet Kuranor, ashtu nuk lejohet të ndryshohet ndonjë kusht apo nuk lejohet të ndryshohet destinimi i të hyrave të atij vakëfi.

Ndërsa, sa i përket atij i cili e ndryshon destinimin e të hyrave të vakëfit, mallkimi bie mbi të. Për këtë arsye, pas kushteve të vakëfit, zakonisht, përdoren këto fjali **“Mbi atë që i prish ose i ndryshon kushtet e këtij vakëfi, rëntë mallkimi i Allahut, i pejgamberëve, i melekëve, i njerëzve dhe i të gjitha krijesave”**.

Edhe pse çështja është për testamentin, prapëseprapë ka të bëjë edhe për vakëfin dhe çështjet tjera, kur Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an ka thënë:

“Dhe kush e ndryshon atë pasi ta këtë dëgjuar atë, atëherë pa kurrëfarë dyshimi mëkati për këtë bie mbi ata të cilët e kanë ndryshuar (dëstinimin e tij). Vërtet Allahu dëgjon dhe është i ditur”.(El-Bekare,181).

SHITJA E VAKËFIT

Dijetarët Hanefij dhe të tjerë kanë dhënë fetva se nëse vakëfi shitet, kjo shitje është e pavlefshme (batil).

Omeri r.a. kur ka lënë vakëf (e ka dhënë sadaka) ka kushtëzuar që ajo tokë:

As të mos shitet,

As të mos dhurohet,

As të mos trashëgohet (pronësohet)

por të mirat e asaj toke të jenë për të varfrit, të afërmit, për të liruar robërit, për udhëtarët, për mysafirët.

Transmeton xhemati (grup transmetuesish)

Për këtë arsye, këta dijetarë kanë paraparë se një nga kushtet e vakëfit është që dhurimi për vakëf të jetë përgjithmonë, e jo të jetë i përkohshëm.

Nëse vakëfi humbet nga papërgjegjshmëria e të tjerëve, kjo do të thotë se personi, i cili e ka lënë atë si vakëf, do të privohet nga shpërblimi i saj pas vdekjes. Kjo përbën thyerje të amanetit ndërsa thyerja e amanetit ndëshkohet nga Allahu. Gjithashtu, një akt i tillë përbën shpërdorim të pronës së muslimanëve dhe privon ata nga të ardhurat që vihen nga ai vakëf në dobi të tyre dhe, si i tillë, ai edhe ligjërisht ndëshkohet.

TOKA VAKËF MBI TË CILËN MË PARË KA PASUR NJË XHAMI

Nëse një xhami është rrënuar dhe ka mbetur toka, sipas medhhebit Hanefi, ajo tokë, ai vend konsiderohet xhami deri në ditën e kiametit dhe, sipas mendimeve të dijetarëve të medhhebit hanefij, shafij, hanbelij dhe disa dijetarëve të medhhebit malikij: xhamia duhet të rindërtohet në të njëjtin vend, pasi toka mbi të cilën ka qenë e ngritur xhamia ngelet xhami, edhe nëse xhamia është prishur.

Njësoj edhe nëse një xhami ka qenë dykatëshe, apo një pjesë e një xhamie ka qenë dykatëshe: kati i dytë, apo pjesa e katit të dytë duhet patjetër të rikthehet, sepse vakëfi, siç ndërtohet horizontalisht, ndërtohet edhe vertikalisht.¹

1. Në vitin 1939-1940, në mafilin e madh të xhamisë Gazi Sinan Pasha, i cili mafil është ndërtuar me siguri para 200 vjetësh, para 40 hoxhallarëve, prej 60-70 nxënësve, sa kanë mësuar te Mulla Rufati në këtë mafil, duke e luajtur rolin edhe të mektebit, edhe të faljes në namaz të xhumasë, të teravive, Bajramave, kanë bërë hatme 7 nxënës (baballarë tanë), e ata janë:

- 1.Nejaz Hoxha
- 2.Vebi Przha
- 3.Ahmet Nallbani
- 4.Dehar Axhami
- 5.Fari Lika
- 6.Zija Lika dhe
- 7.Selim Muhaxheri

Sot ai mafil është asgjësuar dhe është eliminuar në tërësi më rastin e restaurimit të xhamisë.

Sa namazi është falur në atë mafil,e sa nxënësi ka mësuar në atë mafil, e sot

“Mbi ata, të cilët e kanë ndryshuar dhe kanë asgjësuar 100 m² të mafilit të xhamisë Koxha Sinan Pasha, rëntë mallkimi i Allahut, pejgamberëve, melekëve, i njerëzve dhe i të gjitha krijesave”.



Mafili para restaurimit (100m²)



Pas restaurimit mafili është hequr dhe është zëvendësuar me kupola, megjithëse ka pasur mundësi të bëhet edhe mafili edhe kupolat

VAKËFI I VASIJETIT (TESTAMENTIT)

Dallimi në mes të Vakëfit dhe Vasijetit qëndron në atë se Vasijeti fuqizohet pas vdekjes së testamentlënës, ndërsa vakëfi fuqizohet para vdekjes së vakëflënës. Nga kjo kuptojmë se Vakëfi mund të lihet edhe nëpërmjet rrugës së testamentit.

Edhe lënia vakëf ndryshon prej lënies vakëf nëpërmjet testamentit:

Një individ në gjendje të shëndoshë mund të lërë vakëf edhe më shumë se një të tretën e pasurisë së tij

I njëjti individ në gjendje të sëmurë apo në shtratin e vdekjes nuk ka të drejtë të lërë vakëf më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, qoftë me testament, qoftë si vakëf të menjëhershëm; ai mund të lërë vakëf vetëm më pak se një të tretën e vlerës së pasurisë së tij.

Nëse trashëgimtarët ia lejojnë të sëmurit që të lërë më shumë se një të tretën, atëherë ai vakëf, qoftë me testament, qoftë i menjëhershëm, lejohet.

Nëse vakëflënësi ka lënë vakëf më shumë se një të tretën e pasurisë, atëherë i zbatohet vetëm një e treta, ndërsa ajo që është më shumë se një e treta u kthehet trashëgimtarëve dhe nuk i zbatohet më shumë se një e treta.

Nëse vakëflënësi nuk ka trashëgimtarë fare, ka të drejtë të lërë vakëf tërë pasurinë e tij.

Nëse një person ndërton një xhami, kjo llogaritet se ajo xhami është vakëf, sepse xhamitë nuk konsiderohen pronë personale, por xhamitë janë të papronësuar.

VAKËFI ËSHTË EMANET

Me të drejtë është thënë: Ruhuni nga shkronja “**vav**”. Pra, qëllimi i kësaj maksime ka qënë:

- Ruhuni nga shkronja “**vav**” e përbetimit të kotë, siç përdoret pa kurrëfarë nevojë “**Vallahi**”, pasha Allahun.

- Ruhuni nga shkronja “**vav**” – **veliut (përgjegjësit)** – kur dikush e merr një përgjegjësi dhe sillet i pandërgjegjshëm.

- Ruhuni nga shkronja “**vav**” – **vasijut** – të qenit trashëgimtar, që nuk i zbaton të drejtat e të tjerëve.

- Ruhuni nga “**vav**” i **Vakëfit** – pra të shpenzuarit jo sipas qëllimit, që sjell dënim të rëndë.

Pra, duhet ruajtur nga këto fjalë, të cilat fillojnë me shkronjën “vav”.

Maksima nuk ka për qëllim heqjen dorë nga detyrat dhe përgjegjësitë, por, përkundrazi, marrja përsipër e këtyre përgjegjësiave dhe kryerjen e detyrave me përpikëri, p.sh. malli i dhuruar si vakëf, që nga momenti kur të dalë nga pronësia e ish pronarit të tij, nuk mund të shitet, nuk mund të falet dhe nuk mund të lihet si trashëgim. Duke u nisur nga kjo, në regjistrat e vakëfnameve shkruhen edhe lutje, edhe mallkime. Lutja bëhet për ata të cilët i shërbejnë vakëfit me përpikëri, përderisa mallkimi bëhet ndaj atyre që e shkelin vakëfin, e keqpërdorin dhe nuk e plotësojnë qëllimin e dhurimit të vakëfit; zakonisht shkruhet ky tekst: **“Mbi atë që i prish ose i ndryshon kushtet e këtij vakëfi rëntë mallkimi i Allahut, pejgamberëve, melekëve, i njerëzve dhe i të gjitha krijesave”**.

Siç shihet, është obligueshmëri që ndaj vakëfit të ketë kujdes të veçantë, sepse nëse ky emanet shkelet, pason dënimi i dhimbshëm, p.sh.: Mrekullia e pejgamberit Salih ka qënë devja, e cila nuk ka qënë pronë e askujt, por ka qënë vakëf, e cila është lënë për njerëzit që të përfitojnë prej saj. Pronar i vetëm i saj ishte Zoti, mirëpo fisi e ka mbytur atë deve, duke e shkelur amanetin dhe si përfundim ai fis është shkatërruar.

OBJEKTET E VAKËFEVE

Objektet e vakëfeve janë:

Xhamitë: Xhamia është kult Islam dhe zë vendin e parë në lënie të vakëfeve xhami, ndërsa të gjitha llojet tjera vijnë në rend të dytë. Mirëpo, duhet ditur se xhamia nuk e ka vetëm rolin e tubimit të faljes, por e ka rolin edhe të nevojave të tjera, si shoqërore ekonomike, kulturore, arsimore etj.etj.

Musalat: quhen vendfalje të hapura, të cilat nuk ndërtohen si xhami. Kjo zakonisht bëhet në vendet ku kushtet klimatike janë të përshtatshme për përcaktimin e atyre vendfaljeve në ambient të hapur.

Mesxhidet: Dallimi në mes te xhamive dhe mesxhideve qëndron në atë se xhamitë posedojnë minare, ndërsa ajo nuk është e patjetërsueshme për mesxhidet.

Medreset (shkollat): Zakonisht janë ndërtuar afër xhamive dhe si objekt arsimor jo vetëm fetar, por edhe si objekte edukativo-arsimore dhe shkencore.

Bibliotekat: Zakonisht bibliotekat ndërtohen afër medreseve, me qëllim që nxënësit të shfrytëzojnë literaturën e nevojshme.

OBJEKTET VAKËFNORE PËR ÇËSHTJE HUMANITARE

Vakëf lihen edhe për qëllime humanitare, si: për të varfër, jetim, studentë, udhëtarë, të sëmurë, për larjen e borxheve, si dhe për kafshët.

1. **Studentët:** Feja Islame është fe e shkencës dhe e diturisë. Për këtë arsye i është dhënë rëndësi e posaçme studentëve dhe hulumtuesve shkencorë.
2. **Imaretet:** Janë kuzhinat publike në të cilat përgatitet ushqim dhe jepet falas për personat të cilët i parasheh vakëflënësi, si p.sh.: për jetimët, skamnorët, udhëtarët, studentët etj.
3. **Mysafirhane:** janë hotelet ku mund të pushojnë falas udhëtarët, haxhinjtë, studentët etj.
4. **Karavan saraje:** janë objekte me livadhe, të cilat ndërtohen në rrugë kryesore për t'i sistemuar kafshët, ushqyer dhe të qëndrohet aty pa pagesë. Në kohët e sotme mund të ndërtohen parkingje pa pagesë për udhëtarët nëpër autostrada dhe në rrugët dytësore apo në qendra të qyteteve ku është e nevojshme.
5. **Spitalet :** përpos objekteve tjera vakëfnore, muslimanët kanë ndërtuar spitale, në të cilat janë shëruar të varfërit pa pagesë, pa marrë parasysh etnitetin e tyre fetar.
6. **Të ngarkuarit në borxhe:** kësaj kategorie i takon edhe zekati, kështu që ndonjë vakëflënës lë vakëf që të hyrat prej atij vakëfi të shpenzohen për këtë kategori.
7. **Kafshët:** në fillim të islamit dhe gjatë zhvillimit të tij, në të drejtën islame është themeluar edhe institucioni policor, apo kontrollor, që pos kontrollimit të çmimeve në treg, kualitetin e prodhimit, kanë pasur për detyrë që edhe pronarët e kafshëve transportuese dhe jo transportuese t'i dënojnë, nëse ata sillen ashpër me kafshët e tyre, qofshin ato: kuaj, deve, dele, lopë etj. Ky institucion është quajtur "**Medhalim**", që ndryshe mund ta përkthejmë: Sigurimi i të dobtëve, apo atyre të cilëve u bëhet e padrejtë. Nga mëshira për kafshët për të cilat Muhamëdi a.s. ka insistuar të sillet mirë me ta, muslimanët kanë lënë vakëfe edhe për ta.

THEMELIMI I VAKËFEVE PËR INTERES TË PËRGJITHSHËM

Vakëfet, përpos që janë të parapara për objekte fetare dhe për objekte për përkujdesjen e një pjese të shoqërisë, e cila është nevojtare, si psh. për jetimët, të varfrit, udhëtarët etj, mund të jenë edhe për interesin e përgjithshëm shoqëror, e që në këtë rast e merr karakterin e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi. Vakëfi nuk mund të titullohet si pronë publike, çfarëdo qoftë ai vakëf, edhe pse të gjitha vakëfet janë pronë publike, sepse çdo pronë, e cila është pronë e Allahut, në të njëjtën kohë konsiderohet se është pronë publike.

Urat: Ndërtimi i urave si vakëf bëhet për arsye të ndryshme, si për lidhjen e qyteteve, për tregti, për të shkuar në xhami. Vakëflënësi fiton shpërblim, sepse urat shfrytëzohen për interes të përgjithshëm të shoqërisë.

Ujësjiellësit: Uji është jetë. Ajo çka më së miri i shërben njeriut është uji. Për këtë të parët tanë i kanë kushtuar kujdes të veçantë hapjes së puseve, ndërtimit të ujësjiellësve, kudo që ka pasur nevojë.

Na është përcjellur se Sead Ibn Ubade r.a. i ka thënë të dërguarit të Allahut s.a.v.s.: O i dërguar i Allahut, nëna më ka vdekur. Cila është sadakaja më e mirë për të?

Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: Uji.

Atëherë Seadi e ka hapur një pus dhe ka thënë: Ky pus është (vakëf) për nënën e Seadit.

Banjo publike: Pasi që feja Islame është fe e pastërtisë, atëherë Islami i kushton kujdes të veçantë mjeteve dhe objekteve të pastërtisë. Kështu, në civilizimin Islam shohim se muslimanët kanë ndërtuar banjo publike ku është bërë pastrimi pa pagesë, të cilat janë quajtur **Hamame**.

Urat, ujësjiellësit, banjot publike, imaretet, karavan sarajet, mysafirhanet, spitalet, bibliotekat e të ngjashme kanë zhvilluar kulturën islame, por në të njëjtën kohë edhe shoqërinë islame, ndërsa islamin e kanë lartësuar.

VAKËFNAMEJA

Në përgjithësi, të gjitha vakëfimet në të kaluarën kishin formë të njëjtë.

Në rend të parë në vakëfime shkruhet “Falënderimi ndaj Allahut”, pastaj shkruhet “Emri i Vakëflënës, e më tej shkruhet në detaje çka dhe sa lihet vakëf dhe se për çfarë qëllimesh do të shpenzohet.

Lutja për ata të cilët i shërbejnë vakëfit në përpikëri: Mallkimi i Allahut për ata të cilët i ndryshojnë dhe prishin qëllimin e vakëfit. Në fund shkruhen emrat e dëshmitarëve.

Ja, një mostër se si të shkruhet një vakëfime:

Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim

Falënderoj Zotin e Madhërishëm, Krijuesin e të gjithbotëve, Sunduesin absolut.

Unë, Filani, djali i filanit, rob i Allahut, po e lë vakëf këtë objekt (këtë livadh, këtë inventar) sipas kushteve të mëposhtme:

X objektin (X Parcelën) për nevojat e jetimëve dhe të varfërve.

X objektin për nevojat e xhamisë dhe për studentët.

Ai i cili shërben në Vakëf, atij i caktohet shuma në vlerë x euro dhe Lus Zotin që ai të ketë shpërblim në botën tjetër.

“Mbi atë, i cili abuzon, ndryshon destinimin e vakëfit, që i prish ose i ndryshon kushtet e këtij vakëfi, rëntë mallkimi i Allahut, pejgamberëve, melekëve, i njerëzve dhe i të gjitha krijesave.

“Dhe kush e ndryshon atë pasi ta ketë dëgjuar atë, atëherë pa kurrëfarë dyshimi mëkati për këtë bie mbi ata të cilët e kanë ndryshuar (destinimin e tij). Vërtet Allahu dëgjon dhe është i ditur”. (El-Bekare, 181).

Vakëflënësi

Dëshmitari i parë: *Nënshkrimi*

Dëshmitari i dytë: *Nënshkrimi*

Data-----

Vëndi-----

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.
21. “Texhvidi i muslimanit të vogël”.
22. “Morali i muslimanit të vogël”.
23. “Vasijeti”
24. “Ixhtihadi”.
25. “Trashëgimia”.
26. “Usuli Fikhu Islam”.
27. “Lutjet e jetës nga Kur'ani Fisnik”.
28. “Vakëfi”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. *“Këshilltari fisnik për djem dhe vajza”* (nga autori Muhamed Sajim);
2. *“Islami dhe Politika”* (nga autori Jusuf Kardavi);
3. *“Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik”* (nga autori Abdurrëzak Nufel);
4. *“Për Kushtetutën Islame”* (Dr. Muhamëd Sejid Ahmed El-Musejer);
5. *“Kryesore në terminologjinë e Hadithit”* (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. *“Vlera e kohës”* (nga autori Amer Halid);
7. *“Vëllazëria muslimane”* (nga autori Amër Halid);
8. *“Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë”* (nga autori Amër Halid);
9. *“Pendimi”* (nga autori Amër Halid);
10. *“Pasojat e mëkateve”* (nga autori Amër Halid);
11. *“Vendosmëria në rrugën e Allahut* (nga Amër Halid);
12. *“Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut* (nga Amër Halid);
13. *“Shkurtimi i thonjve në dritën sunetit dhe mjekësisë”* (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).
14. *“101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë”* (nga autori Muhamed Eminë Xhundi).
15. *“Fetavatë e Shaëravijut”*.
16. *Fjalë të arta të më të mirit të njerëzimit, Muahmedit a.s.*
17. *“Usuli fikhu Islam I -“Ligjet e sheriatit” ” të autorit Vehbetu Zuhejli.*
18. *“Usuli fikhu Islam II -“Përpilimi i ligjeve prej teksteve të sheriatit” ” të autorit Vehbetu Zuhejli.*

PËRMBAJTJA:

HYRJE	4
VAKËFI	6
ARGUMENTI I LIGJËSIMIT TË VAKËFIT	7
DISPOZITA E VAKËFIT	9
QËLLIMI I VAKËFIT	10
LLOJET E VAKËFIT	11
KUSHTET E VAKËFIT	12
LËNDA E VAKËFIT	13
VLEFSHMËRIA DHE REGJISTRIMI I VAKËFIT	14
TEPRICA E VAKËFIT SHPENZOHEP PËR TË NGJASHME	15
DALLIM NË MES TË VAKËFIT DHE SADAKASË	16
NDRYSHIMI DHE TJETËRSIMI I VAKËFIT	17
DESTINIMI I TË HYRAVE TË VAKËFIT	18
SHITJA E VAKËFIT	19
TOKA VAKËF MBI TË CILËN MË PARË KA	
PASUR NJË XHAMI	20
VAKËFI I VASIJETIT (TESTAMENTIT)	22
VAKËFI ËSHTË EMANET	23
OBJEKTET E VAKËFEVE	24
OBJEKTET VAKËFNORE PËR ÇËSHTJE HUMANITARE	25
THEMELIMI I VAKËFEVE PËR INTERES	
TË PËRGJITHSHËM	26
VAKËFNAMEJA	27
LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbani)	28
PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE	29